

VENDIM
Nr. 6, datë 4.2.2016

PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR NJË PROJEKT TË PROGRAMIT TË SHËNDETËSISË, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE, PËR VITIN 2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për një projekt në vazhdim, me cikël financimi 2014–2015, për programin e shëndetësisë, specifikuar sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shëndetësisë, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,	
Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe	
Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin	
dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1. Projektet në vazhdim, në programin e Shëndetësisë, me cikël financimi 2014–2015

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e kontratës (lekë)	Vlera e realizuar për vitin 2015 (lekë)	Vlera shtesë e realizuar për vitin 2015 (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (lekë)
Qarku Lushnjë						
1	Bashkia Divjakë	Ndërtimi i Qendrës Shëndetësore, Divjakë	46,965,000	22,600,000	9,365,000	15,000,000
		Totali	46,965,000	22,600,000	9,365,000	15,000,000

Shënim:

1. “Vlera e kontratës” përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, të kërkuar për financim nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve. Vlera e kontratës përcillet nga Sekretariati Teknik (Ministria e Shëndetësisë).

2. “Vlera e realizuar për vitin 2015” tregon vlerën e alokuar për vitin 2015, deri në 31.12.2015. Vlera e realizuar përcillet nga Sekretariati Teknik (Ministria e Shëndetësisë).

3. “Vlera shtesë e realizuar për vitin 2015” tregon vlerën e financimit, shtesë të alokuar për vitin 2015, nga 2 aktet normative të ligjit për buxhetin, për vitin 2015. Vlera e shtesë, e realizuar përcillet nga Sekretariati Teknik (Ministria e Shëndetësisë).

4. “Vlera e financimit për vitin 2016”, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës, vlerës së realizuar dhe vlerës shtesë së realizuar, për vitin 2015.